



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 269/19
271/19
279/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Nuhi Paçarizi– Kryetar, z.Blerim Dina–Referues, z.Goran Milenković –Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatoret Ekonomik: N.T.SH.“Delfina” – Malishevë, për Lot 2 dhe 3, ankesën e OE N.T.G.”Blendi” për Lot 4 dhe ankesën e OE “Europrinty”SH.P.K. – Prishtinë, për Lot 3 kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku janë rekomanduar për kontratë Operatoret Ekonomik: N.T.P.“Mali-I”për Lot 2 dhe “Bursam Gold” SH.P.K. për Lot 3 dhe 4, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me mobileje për nevoja të konvikteve në Qendër të Studenteve” – Lot: 2, 3, 4 me numër të prokurimit: 1020890500-19-1786-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Qendra e Studenteve, më datën 20.06.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatoreve N.T.SH.“Delfina” – Malishevë, ankesa e OE N.T.G.”Blendi” dhe ankesa e OE “Europrinty”SH.P.K. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me mobileje për nevoja të konvikteve në Qendër të Studenteve” – Lot: 2, 3, 4, me numër të prokurimit: 1020890500-19-1786-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Qendra e Studenteve.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me mobileje për nevoja të konvikteve në Qendër të Studenteve” – Lot: 2, 3, 4,, me numër të prokurimit: 1020890500-19-1786-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Qendra e Studenteve dhe aktiviteti i prokurimit për **LOT 2,3 dhe 4 kthehet në Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatoreve ekonomik ankues N.T.SH. "Delfina" – Malishevë, OE N.T.G. "Blendi" dhe OE "Europrinty" SH.P.K. – Prishtinë, aprovohen pjesërisht si e bazuar, te tre operatoreve ekonomik ju bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 05.04.2019

Hapja e ofertave është bërë me dt: 26.04.2019

Njoftimi për tenderues të pasukseshëm dt: 06.05.2019

Njoftimi mbi vendimin e AK-së dt: 06.05.2019

Kërkesa për rishqyrtim dt: 13.05.2019

Vendimi i AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim dt: 15.05.2019

Njoftimi për eliminimin e tenderuesit : dt: 21.05.2019

Njoftimi mbi vendimin e AK-së dt: 21.05.2019

Kërkesa për rishqyrtim dt: 20.05.2019.

Kërkesa për rishqyrtim dt: 25.05.2019.

Autoriteti Kontraktues me datën 21 dhe 27 .05.2019 ka marrë vendim që të refuzohen kërkesat për rishqyrtim si të pa bazuara nga OE. N.T.SH. "Delfina" – Malishevë, dhe N.T.G. "Blendi" dhe "Europrinty" SH.P.K. – Prishtinë,

Operatori ekonomik ankues N.T.SH. "Delfina" – Malishevë, dhe N.T.G. "Blendi"- Prishtinë, si palë tëpa kënaqura, kanë deponuar ankesë në OSHP, me datë 31.05.2019 me nr. 269-271/19, dhe "Europrinty" SH.P.K. – Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 03.06.2019 me nr. 279/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me

mobileje për nevoja të konvikteve në Qendër të Studenteve” – Lot: 2, 3, 4, me numër të prokurimit: 1020890500-19-1786-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Qendra e Studenteve, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues për OE. N.T.SH.“Delfina” – Malishevë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59.4, dhe 60.1.1 Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.
- Autoriteti kontraktues për OE ankues N.T.G.”Blendi”- Prishtinë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 28, 52.3, 59, dhe 108/A pikë 2, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe
- Nenin 18 dhe 20 të UOPP-së .
- Autoriteti kontraktues për OE ankues ”Europrinty” SH.P.K.- Prishtinë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 28, 59, dhe 60, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe
- Nenin 41 i A01 të UOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.06.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt:11.06.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim: **Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: N.T.SH. “Delfina” – Malishevë**

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar dispozitat ligjore ka shkelur nenin 1, 6, 7, 59.4, 60.1.1 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit (në këtë aktivitet të prokurimit) komisioni i Rivlerësimit nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar, ofertat e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk ka respektuar **nenin 59 par. 4 të LPP-së**, po citoj: “*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*”, si dhe **nenin 7 par. 1 të LPP-së**, po citoj: “*Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*”, Po ashtu, autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit tek *Pjesa B: Draft Kontrata Publike Kornize, Kushtet & Anekset e*

ndërlidhura – Kushtet e përgjithshme te Kontratës bazuar tek Neni 2 Kushtet e dërgesës, par. 2.3 po citoj: Inkotermi i zbatueshëm do te jete DDP ⁴ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).- Vëmendje:DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Gjithashtu, ekspertit shqyrtues sqaron bazuar edhe ne interpretimin e KRPP-se nr. 46 tek pyetjet e shpeshta ne web faqen e KRPP-së, po citoj: “ Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë”.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara qe te sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrën me ekonomike, njëkohësisht duke marr ne konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet ne nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikas, me transparent dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve dhe burimeve publike. Andaj, AK – Qendra e Studenteve, nuk ka vepruar ne pajtim me dispozitat ligjore te LPP-së.

Prandaj, në bazë të analizës se dokumentacionit te prezantuar, sqarimeve si me lart, pretendimet e palës në ankesë në këto pika/pretendime janë të qëndrueshme.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: N.T.G. “Blendi” – Prishtinë:

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka vepruar sipas FDT-se dhe njoftimit për kontratë konkretisht nenit 1, 6, 7, 53.3 dhe 59 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kam pranuar ne shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit (ne këtë aktivitet te prokurimit) komisioni i Rivlerësimit nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar, ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit AK nuk ka respektuar nenin 7 par. 1 të LPP-së, po citoj: “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”nenit 52 par.3 Po citoj: “Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim” nenin 59 par. 4 të

LPP-së, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, prandaj, duke u bazuar në këto fakte dhe pasi që AK në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk ka kërkuar fare të prezantohen/dorëzohen mostrat pran AK, lidhur me LOT 4 andaj, duke pas parasysh nenet e lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika janë të qëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikas, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike. Prandaj, në bazë të analizës së dokumentacionit të prezantuar, sqarimeve si më lart, pretendimet e palës në ankesë në këto pika/prendime janë të qëndrueshme.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar **nenin 28 të LPP-së** dhe **nenin 20** specifikimet teknike të RrUOPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi i operatorit ekonomik ankues lidhur me shkeljet lidhur me specifikat teknike, nëse OE ka pasur paqartësi dhe supozime se ka shkelje të këtij neni ka mundur të kërkojë sqarime shtesë në afatin kohor të përcaktuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit (nuk kam hasur në platformën elektronike nga OE ankues ndonjë kërkesë për sqarime apo kërkesë për rishqyrtim lidhur me njoftimin për kontratë), andaj OE ankues një gjë të tillë nuk e ka shfrytëzuar dhe nuk ka jap asnjë sqarim lidhur me këtë nen tek deklaratat e detajuara mbi faktet dhe argumentet (është përgjegjësi e AK të vendos specifikimet teknike sipas LPP-së), prandaj konsideroj se nuk ka shkelje të këtij neni, duke u bazuar në këto fakte dhe duke pas parasysh analizën e mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk qëndron**.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues se AK nuk ka respektuar **nenin 108/A par.2 të LPP-së**.

Eksperti shqyrtues sqaron se bazuar në Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Dhe AK është i obliguar menjëherë/automatikisht të pezullojë

aktivitetin e prokurimit dhe te ngrit ne platformën elektronike e-prokurimi, vendimin për pezullim te aktivitetit te prokurimit ne pajtim me nenin 108/A par. 2te LPP-së, po citoj: *“Dorëzimi i një kërkesë për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar”*. Miro, gjate shqyrtimit ne platformën elektronike nuk kam hasur vendimin për pezullim nga AK, prandaj, në bazë të analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: “Europrinty” SH.P.K. – Prishtinë:

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 28 të LPP-së dhe nenin 20 specifikimet teknike të RrUOPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi i operatorit ekonomik ankues lidhur me shkeljet lidhur me specifikat teknike, nëse OE ka pasur paqartësi dhe supozime se ka shkelje te këtij neni ka mundur te kërkoj sqarime shtese ne afatin kohore te përcaktuar ne njoftimin për kontratë dhe dosje te tenderit (nuk kam hasur ne platformën elektronike nga OE ankues ndonjë kërkesë për sqarime apo kërkesë për rishqyrtim lidhur me njoftimin për kontrate), andaj OE ankues një gjë te tille nuk e ka shfrytëzuar dhe nuk ka jap asnjë sqarim lidhur me ketë nene tek deklarata detale mbi faktet dhe argumentet (është përgjegjësi e AK te vendos specifikimi teknike sipas LPP-se), prandaj konsideroj se nuk ka shkelje te këtij neni, duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë në këto pika nuk qëndrojnë.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së dhe nenin 41 të RrUOPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kam pranuar ne shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit (ne këtë aktivitet te prokurimit) komisioni i Ri-vlerësimit ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar, ofertën e OE ankues e ka vlerësuar ne pajtim me dispozitat ligjore te LPP-se, duke rekomanduar për dhënie te kontratës. Mirëpo komisioni i veçantë për pranimin e mostrave ne raportin e tij te datës 14.05.2019 nxjerr këtë konstatim, po citoj:

1. Baza e karriges është material i pa plastifikuar

2. Mbështetja e karriges nuk është ne përputhje me kriterin e kërkuar, mbështetësja nuk është me rrjet ekologjike.

3. Lartësia e mbështetëses nga toka është nen minimalen 84 cm (duhet te jete 85 cm – 90 cm) .

Prandaj duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK, analizës se mësipërme si dhe ankesën e OE ankues tek DEKLARAT DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET, jap këtë

deklaratë/arsyetim po citoj: *“Karriget e prezantuar nga ana jone është edhe me e mire se ne foto te cilën e kane AK, karrige ka eco lëkur ne ulësen, gjithashtu ne kemi prezantuar mostrën edhe ne mbështetëse eco lëkure qe është ma e mire se rrjeta dhe ka qenë e lartësisë siç është kërkuar”* qe do te thotë se vet e pohon se nuk është sjellë mostra ashtu siç është kërkuar te specifikat teknik

Po ashtu ne një pjese tjetër OE ankues jep këtë deklaratë/arsyetim po citoj: *“ne kemi bere te pamundurën për ta gjetur ashtu identike mostrën edhe pse ne tregun tone nuk ka pasur këto behën vetëm me porosi nga China ne kemi beret e pamundurën dhe ditën e fundit te cilën e kemi pasur për ta dorëzuar ne kemi dërguar një mostër te ngjashme me te cilën ata na kane kërkuar”*.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kam pranuar ne shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit ne këtë aktivitet te prokurimit dhe shkeljet dispozitave ligjore te LPP-se qe kanë ndodhur ne këtë procedure, rekomandoj AK qe këtë aktivitet te prokurimit te kthej ne Ri-vlerësim dhe te vazhdoj te respektoj ne tërësi dispozitat ligjore te LPP-se.

Prandaj duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika është **pjesërisht te qëndrueshme**.

Gjithashtu, Eksperti Shqyrtues sqaron si ne vijim: Është përgjegjësi, dhe ne diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht e komisionit te vlerësimit qe gjatë procesit te vlerësimit te tenderuesve, te trajtoj dhe analizoje çmimin, apo te konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me nenin 61 te LPP-së, ne mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara në Aneksi 1, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura dhe rregullave ku janë të publikuar në web-faqen e KRPP-së, në formularin B57.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara qe te sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrën me ekonomike, njëkohësisht duke marr ne konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet ne **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikas, me transparent dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve dhe burimeve publike. Andaj, AK – Qendra e Studenteve, nuk ka vepruar ne pajtim me dispozitat ligjore te LPP-së.

Eksperti shqyrtues profesional, duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezantuara në dosjen e tenderit, raport, si dhe rrjedhën nga ana e AK-së, lidhur me tenderin e AK: **QENDRA E STUDENTEVE**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me mobilje për nevoja të konvikteve në Qendra të Studenteve”** – Lot: 2, 3, 4, me nr. prokurimi: 1020890500-19-1786-1-1-1, lidhur me pretendimet ankimore si me poshtë:

Pretendimet ankimore të OE ankues N.T.SH. **“Delfina”** – Malishevë lidhur me rekomandimin e për dhënie të kontratës për Lot 2 dhe Lot 3 të **aprovet si të bazuar**, dhe të njëjtin tender rekomandojmë, Autoritetin Kontraktues, që të rishyrtoj edhe një herë vendimin e vet dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**.

Pretendimet ankimore të OE ankues N.T.G. **“Blendi”** – Prishtinë, lidhur me rekomandimin e për dhënie të kontratës për Lot 4:, të **aprovet si të bazuar**, dhe të njëjtin tender rekomandojmë, Autoritetin Kontraktues, që të rishyrtoj edhe një herë vendimin e vet dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**.

Pretendimet ankimore të OE ankues **“Europrinty” Shpk** – Prishtinë, lidhur me rekomandimin e për dhënie të kontratës për Lot 3:, të **aprovet si pjesërisht e bazuar**, dhe të njëjtin tender rekomandojmë, Autoritetin Kontraktues, që të rishyrtoj edhe një herë vendimin e vet dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**.

Operatorët ekonomik “N.T.SH. “Delfina” – Malishevë, dhe “Europrinty” SH.P.K. – Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 11.06.2019, kanë njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik OE ankues N.T.G. “Blendi”- Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 12.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 12.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 20.06.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe përfaqësuesit e operatoreve ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesat e operatoreve ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së se pare ankuese z. Mazreku deklaroj: Pretendimet tona ankimore janë shqyrtuar nga eksperti i prokurimit dhe të gjitha ato pretendime janë konform LPP-së dhe janë arsyetuar mjaftueshëm nga Eksperti.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së se dytë ankuese. z. Deva deklaroj: Ne kemi parashtruar ankesën ne OSHP kemi dhënë arsyeshëm pretendimet ankimore ku Autoriteti Kontraktues i ka shkelur këto i ka vërtetuar edhe eksperti shqyrtues, andaj plotësisht e mbështesim raportin e ekspertizës.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së se dytë ankuese. z. Berisha deklaroj: te pa kënaqur me vendimin Autoriteti Kontraktues kemi ushtruar ankese ne OSHP ku kemi theksuar se Autoriteti Kontraktues ka shkelur ligjin e prokurimit publik dhe këto pretendime ankimore i ka vërtetuar edhe E.SH. ku mjaft qartë i ka dhen ne ekspertizën e datës 11.06.2019. Pasi qe me është kërkuar qe te dorëzoj modelin- mostrën nga Autoriteti Kontraktues me është prezantuar mostër tjetër ne konviktin Nr 7. E qe ajo mostër nuk gjendet askund ne Tregun e Kosovës.

Gjatë prezantimit ne seancë përfaqësuesi i AK-së z. Lepaja i cili deklaroj: Ne nuk jemi pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues sepse OE ankues N.T.SH. “Delfina” është shpallur fitues, mirëpo gjatë vlerësimit është vërejtur se ai ka gabime aritmetike mbi 2% në të gjitha artikujt dhe vlera totale është mbi 2%, gabimet aritmetike janë vetëm ne normën e TVSH-se. Ky OE ka sjell mostrat qe kanë qen konform FTD por eliminimi është ber për shkak te gabimeve ne TVSH. N.T.SH. “Delfina” ka qene për Lot 2. Eksperti ka thënë se duhet me ndryshuar vlerën e TVSH-së dhe e kemi ndryshuar kurse ka rezultuar vlera totale është mbi 2%.

Për 2 OE-të etjerë N.T.G. “Blendi” është bere vlerësimi dhe me vendim te Autoriteti Kontraktues është shpallur fitues kurse prej 06.05.2019 i është kërkuar sjellja e mostrës, OE e ka sjell mostrën por jo adekuate me specifikat e kërkuar, dhe komisioni i vlerësimit ia ka refuzuar mostrën.

E njëjta gjë vlen edhe për OE “Europrinty” SH.P.K. pasi qe është shpall fitues nga komisioni vlerësues edhe ky OE i ka plotësuar kriteret, pasi është kërkuar mostra edhe ky OE nuk e ka sjellë mostrën ashtu siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Mostrat nuk kanë qenë kriter i vlerësimit mirëpo kanë pranuar me sjellë.

Sa i përket OE të rekomanduar i plotëson të gjitha kërkesat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së parë ankuese deklaroj: Propozojmë të aprovohet ankesa jonë plotësisht e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së dytë ankuese deklaroj: I propozojmë panelit shqyrtues të aprovoj plotësisht të bazuar ankesën tonë dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së tretë ankuese deklaroj: I propozojmë panelit shqyrtues të aprovoj plotësisht të bazuar ankesën tonë dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: I propozojmë Panelit që të refuzohen ankesat e OE-ve ankuese si të pabazuara dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional, deklarami të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, në vazhdim jep konstatimet për pretendimet ankimore të OE ankues: N.T.SH. “Delfina” – Malishevë.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar dispozitat ligjore ka shkelur nenin 1, 6, 7, 59.4, 60.1.1 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se komisioni i Ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar, ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk ka respektuar nenin 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, si dhe nenin 7 par. 1 të LPP-së, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”, Po ashtu, autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit tek Pjesa B: Draft Kontrata Publike Kornize, Kushtet & Anekset e ndërlidhura – Kushtet e përgjithshme të Kontratës bazuar tek Neni 2 Kushtet e dërgesës, par. 2.3 po citoj: Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP 4 (Dërgesat e Detyrës të Paguara).- Vëmendje: DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Po ashtu edhe interpretimi i KRPP-se nr. 46 tek pyetjet e shpeshta në web faqen e KRPP-së, po citoj: “ Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-

ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë”.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën me ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën me efikas, me transparent dhe me të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike. Andaj, AK – Qendra e Studenteve, nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së. Prandaj, në bazë të analizës së dokumentacionit të prezantuar, sqarimeve si më lart, pretendimet e palës në ankesë në këto pika/prendime janë të qëndrueshme.

Paneli shqyrtues në vazhdim jep konstatimet për pretendimet e OE ankues: N.T.G. “Blendi” – Prishtinë:

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka vepruar sipas FDT-se dhe njoftimit për kontratë konkretisht nenit 1, 6, 7, 53.3 dhe 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues konstaton se komisioni i Ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar, ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit AK nuk ka respektuar nenin 7 par. 1 të LPP-së, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente” nenit 52 par. 3 Po citoj: “Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim” nenin 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, prandaj, duke u bazuar në këto fakte dhe pasi që AK në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk ka kërkuar fare të prezantohen/dorëzohen mostrat pran AK, lidhur me LOT 4 andaj, duke pasqyruar nënën e lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë në këto pika janë të qëndrueshëm.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikas, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike. Prandaj, në bazë të analizës së dokumentacionit të prezantuar, sqarimeve si më lart, pretendimet e palës në ankesë në këto pika/pretendime janë të qëndrueshme.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 28 të LPP-së dhe nenin 20 specifikimet teknike të RrUOPP-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi i operatorit ekonomik ankues lidhur me shkeljet lidhur me specifikat teknike, nëse OE ka pasur paqartësi dhe supozime se ka shkelje të këtij neni ka mundur të kërkojë sqarime shtesë në afatin kohorë të përcaktuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit (nuk kam hasur në platformën elektronike nga OE ankues ndonjë kërkesë për sqarime apo kërkesë për rishqyrtim lidhur me njoftimin për kontratë), andaj OE ankues një gjë të tillë nuk e ka shfrytëzuar dhe nuk ka dhënë asnjë sqarim lidhur me këtë nen tek deklaratat e detale mbi faktet dhe argumentet (është përgjegjësi e AK të vendos specifikimi teknike sipas LPP-së), prandaj konsideroj se nuk ka shkelje të këtij neni, duke u bazuar në këto fakte dhe duke pasqyruar analizën se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë nuk qëndron.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues se AK nuk ka respektuar nenin 108/A par. 2 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Dhe AK është i obliguar menjëherë/automatikisht të pezullojë aktivitetin e prokurimit dhe të ngritë në platformën elektronike e-prokurimi, vendimin për pezullim të aktivitetit të prokurimit në pajtim me nenin 108/A par. 2 të LPP-së, po citoj: “Dorëzimi i një kërkesë për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar”. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se gjatë shqyrtimit në platformën elektronike nuk është hasur vendimi për pezullim nga AK, prandaj, në bazë të analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Paneli shqyrtues ne vazhdim jep konstatimet e tij lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues: “Europrinty” SH.P.K. – Prishtinë:

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 28 të LPP-së dhe nenin 20 specifikimet teknike të RrUOPP-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se nëse OE ka pasur paqartësi dhe supozime se ka shkelje te këtij neni ka mundur te kërkoj sqarime shtese ne afatin kohore te përcaktuar ne njoftimin për kontratë dhe dosje te tenderit. ne platformën elektronike nuk është hasur nga OE ankues ndonjë kërkesë për sqarime apo kërkesë për rishqyrtim lidhur me njoftimin për kontrate, andaj OE ankues një gjë te tille nuk e ka shfrytëzuar, po ashtu ankuesi nuk ka jep asnjë sqarim lidhur me ketë nene tek deklarata detale mbi faktet dhe argumentet (është përgjegjësi e AK te vendos specifikimi teknike sipas LPP-se), prandaj konsideroj se nuk ka shkelje te këtij neni, duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë në këto pika nuk qëndrojnë.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së dhe nenin 41 të RrUOPP-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional sqaron se duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kam pranuar ne shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit (ne këtë aktivitet te prokurimit) komisioni i Ri-vlerësimit ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar, ofertën e OE ankues e ka vlerësuar ne pajtim me dispozitat ligjore te LPP-se, duke rekomanduar për dhënie te kontratës. Mirëpo komisioni i veçantë për pranimin e mostrave ne raportin e tij te datës 14.05.2019 nxjerr këtë konstatim, po citoj:

1. Baza e karriges është material i pa plastifikuar

2. Mbështetja e karriges nuk është ne përputhje me kriterin e kërkuar, mbështetësja nuk është me rrjet ekologjike.

3. Lartësia e mbështetëses nga toka është nen minimalen 84 cm (duhet te jete 85 cm – 90 cm) .

Prandaj duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK, analizës se mësipërme si dhe ankesën e OE ankues tek DEKLARAT DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET, jap këtë deklaratë/arsyetim po citoj: “Karriget e prezantuar nga ana jone është edhe me e mire se ne foto te cilën e kane AK, karrige ka eco lëkur ne ulësen, gjithashtu ne kemi prezantuar mostrën edhe ne mbështetëse eco lëkure qe është ma e mire se rrjeta dhe ka qenë e lartësisë siç është kërkuar” qe do te thotë se vet e pohon se nuk është sjellë mostra ashtu siç është kërkuar te specifikat teknik, Po ashtu ne një pjese tjetër OE

ankues jep këtë deklaratë/arsyetim po citoj: “ne kemi bere te pamundurën për ta gjetur ashtu identike mostrën edhe pse ne tregun tone nuk ka pasur këto behën vetëm me porosi nga China ne kemi bere te pamundurën dhe ditën e fundit te cilën e kemi pasur për ta dorëzuar ne kemi dërguar një mostër te ngjashme me te cilën ata na kane kërkuar”.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtuesduke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kanë qenë ne shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit ne këtë aktivitet te prokurimit dhe shkeljet dispozitave ligjore te LPP-se qe kanë ndodhur ne këtë procedure, ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bere ne pajtim me nenin 59 te LPP-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se është përgjegjësi, dhe ne diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht e komisionit te vlerësimit qe gjatë procesit te vlerësimit te tenderuesve, te trajtoj dhe analizoje çmimin, apo te konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me nenin 61 te LPP-së, ne mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara në Aneksi 1, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura dhe rregullave ku janë të publikuar në web-faqen e KRPP-së, në formularin B57.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara qe te sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrën me ekonomike, njëkohësisht duke marr ne konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet ne nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikas, me transparent dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve dhe burimeve publike. Andaj, AK – Qendra e Studenteve, nuk ka vepruar ne pajtim me dispozitat ligjore te LPP-së.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –“Qendra e Studenteve” - Prishtinë
1x1 OE –N.T.SH.“Delfina” – Malishevë,
1x1 OE – N.T.G.”Blendi”– Prishtinë,
1x1 OE–“Europrinty” SH.P.K. – Prishtinë,
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1Për publikim në web- faqe të OSHP-së.